



## **NJOFTIMI PER STUDENTET E CIKLIT TE PARE BACHELOR PER PERFITIM BURSE DHE OSE PERJASHTIM NGA TARIFA E SHKOLLIMIT.**

### **NJOFTIM**

#### **PËR KRITERET PËR PËRJASHTIM NGA TARIFA E SHKOLLIMIT DHE PËR PERFITIMIN E BURSIVE NË PROGRAMIN E CIKLIT TË PARË, BACHELOR ME KOHË TË PLOTË PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022**

Bazuar në V.K.M Nr. 40, datë 23.01.2019 dhe V.K.M Nr. 251, datë 27.03.2020 të Këshillit të Ministrave “ Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 269, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, të ndryshuar , dhe V.K.M Nr. 39, datë 23.01.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar, njoftohen të gjithë studentët e FTI-së të programit të ciklit të parë bachelor , se ka filluar procedura për dorëzimin e dokumentave për përjashtimin nga tarifa e shkollimit dhe ose për përfitimin e bursave për vitin akademik 2021-2022.



## KATEGORITË E STUDENTËVE QË PËRFITOJNË BURSË DHE PËRJASHTIM NGA TARIFA E SHKOLLIMIT

Në zbatim të V.K.M Nr. 40, datë 23.01.2019 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave, si dhe V.K.M Nr. 39, datë 23.01.2020 “ Për disa ndryshime në VKM nr. 903, datë 21.12.2016” ,dokumentat që duhet të dorëzojnë studentët të cilët përfitojnë bursë dhe përjashtim nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2021-2022 janë si më poshtë:

Dokumentat që duhet të dorëzojnë studentët sipas kategorive janë si më poshtë:

### a) Studentet, familjet e të cilëve trajtohen me ndihme ekonomike:

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Çertifikate familjare,
2. **Vërtetim nga Njësia Administrative në lidhje me masën e ndihmës ekonomike** që përfiton familja. Vërtetimi i ndihmës ekonomike duhet të ketë të shënuar **numrin e dosjes** dhe të jetë shënuar qartë **shuma e ndihmës ekonomike (me shifra dhe me fjalë)**, si dhe **masa e ndihmës ekonomike (e plotë ose e pjesshme)**. Vërtetimi duhet të jetë me numër protokollit, të jetë nënshkruar nga përgjegjësi i seksionit të ndihmës ekonomike dhe kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe të jetë i vulosur. (Njëkohësisht në vërtetim duhet të jetë e shënuar qartë adresa e Njësisë së qeverisjes vendore që e ka lëshuar për efekt të verifikimit të mëtejshëm)
3. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.
4. Formulari i kërkesë për t'u trajtuar me bursë.

### b) Bashkëshortët që kanë fëmijë dhe janë të dy studentë, përfitojnë secili burse Financiare:

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesë për t'u trajtuar me bursë.
2. Vërtetim studentit nga institucionet publike IAL për secilin prej tyre.
3. Çertifikatë familjare.
4. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.

### c) Studentët, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar:

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesë për t'u trajtuar me bursë.
2. Çertifikatë familjare.
3. Fotokopje e kartës së identitetit;



4. Vërtetim origjinal (ose kopje e noterizuar) të lëshuar nga KMCAP( Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë) për studentin me aftësi të kufizuar;
5. Vërtetimi për pagesën e aftësisë së kufizuar të lëshuar nga zyrat përkatëse (nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore apo nga zyrat e ndihmes ekonomike në Bashki)

**ç) Studentët që i kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar**  
Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesë për t'u trajtuar me bursë.
2. Kopje origjinale ose e noterizuar e Vërtetimit të KMCAP-së ( Komisionit të caktimit të aftësisë për punë) për të dy prindërit me aftësi të kufizuar ( invalid pune, invalid paraplegjik, invalid tetraplegjik).
3. Vërtetim origjinal të institutit të sigurimeve shoqërore për pagesën e pensionit të invaliditetit ose nga Njesia administrative vërtetimin e pagës së paaftësisë për punë( për të dy prindërit)
4. Çertifikatë Familjare që vërteton lidhjen e studentit me invalidin e punës/ invalidin paraplegjik ose tetraplegjik;
5. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.

**d/1) Studentët që i kanë të dy prindërit pensionistë**

1. Formulari i kërkesë për t'u trajtuar me bursë.
2. Çertifikatë Familjare.
3. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit
4. Vërtetim origjinal të institutit të sigurimeve shoqërore për pagesën e pensionit të pleqërisë për prindin/ të dy prindërit.

**d/2) Studentët që e kanë të njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton**

1. Formulari i kërkesë për t'u trajtuar me bursë.
2. Çertifikatë Familjare.
3. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit
4. Vërtetim origjinal të institutit të sigurimeve shoqërore për pagesën e pensionit të pleqërisë të prindërit që jeton;
5. Certifikatë vdekjeje për prindin që nuk jeton;

**dh) Studentët, të tretët në radhën e fëmijëve e lart, të cilët vijnë nga familje me tre fëmijë e më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë:**

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Formulari i kërkesë për t'u trajtuar me bursë.
2. Vërtetim studenti.
3. Çertifikatë Familjare.
4. Vërtetim për të dy fëmijët e parë që janë student në IAL Publike.



**d) Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjec (sipas Ligjit Nr. 8153, date 30.10.1996)**

1. Çertifikatë Familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit;
2. Çertifikatën e vdekjes së dy prindërve;
3. Fotokopje e noterizuar e statusit të jetimit të përfituar nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë;

**e) Studentët që kanë humbur përgjegjësinë prindërore, me vendim gjykate të formës së prerë;**

1. Çertifikatë Familjare
2. Fotokopje e kartës së identitetit;
3. Vendim gjykate i formës së prerë që studenti ka humbur përgjegjësinë prindërore ( nga të dy prindërit ) ;

**f) Studentët që janë identifikuar e trajtuar si viktimat të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror**

1. Çertifikatë Familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit;
2. Vendim gjykate i formës së prerë që kanë humbur kujdesin prindëror;
3. Vërtetim nga Ministria e Mirëqënies Sociale ose Ministria e Brendshme që kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktimat të trafikut të qenieve njerëzore;

**g) Studentët që rezultojnë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.**

1. Çertifikatë Familjare dhe fotokopje e kartës së identitetit;
2. Çertifikatë vdekje e prindit që ka humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës;
3. Vërtetim nga Ministria përkatëse;

- **Studentët e vitit të parë, me notë mesatare vjetore nga 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë**

Lista e studentëve të vitit të parë që plotësojnë kriterin e notës mesatare hartohet nga QSHA, kështu që studentët e kësaj kategorie përfitimi do të dorezojnë numrin e llogarise bankare dhe fotokopje të kartës ID.



- **Studentët e vitit të dytë dhe të tretë, me notë mesatare vjetore të ponderuar nga 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë) të vitit paraardhës akademik, të përlogaritur me kreditet dhe notat e atij vitit akademik, nga institucionet publike të arsimit të lartë. Studentët duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare vjetore e ponderuar.**

Lista e studentëve të vitit të dytë dhe të tretë që plotësojnë kriterin e notës mesatare hartohet nga Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Teknologjise se Informacionit, studentët e kësaj kategorie përfitimi do te dorezojne numrin e llogarise bankare dhe fotokopje te kartes ID.

## **KATEGORITË E STUDENTËVE QË PËRFITOJNË PËRJASHTIM NGA TARIFA E SHKOLLIMIT**

Përvec kategorive më sipër në zbatim të V.K.M Nr. 40, datë 23.01.2019 dhe V.K.M Nr. 251, datë 27.03.2020 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave, përfitojnë vetëm përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit edhe kategoritë si vijon, të cilat duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës:

- **studentët romë dhe egjiptianë, të cilët do të identifikohen nëpërmjet vetëdeklarimit;**
  1. Fotokopje e kartës së identitetit;
  2. Vërtetim anëtarësie në shoqatën përkatëse;
  3. Vetëdeklarim tek noteri;
- **Studentët fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;**
  1. Çertifikatë Familjare që vërteton lidhjen e studentit me prindin të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;
  2. Vërtetimi i statusit të prindit ish të përndjekur/ dënuar politik;
  3. Dëshmi penaliteti për prindin ish të përndjekur politik ose vërtetim për kohën e dënimit të lëshuar nga ministria e punëve të brendshme.



- **studentët, të cilët kanë, të paktën, njërin prind person me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;"**.

- a. Kopje origjinale ose e noterizuar e Vërtetimit të KMCAp-së ( Komsionit të caktimit të aftësisë për punë) për studentin me prindër me aftësi të kufizuar;
- b. Vërtetim të institutit të sigurimeve shoqërore për pagesën e pensionit të invaliditetit/ ose vërtetim të masës së pagesës të aftësisë së kufizuar ;
- c. Çertifikatë Familjare që vërteton lidhjen e studentit me prindin me aftësi të kufizuar;
- d. Fotokopje të kartës së identitetit të studentit dhe të prindit invalid;

### **NUK PËRFITOJNË PËRJASHTIM NGA TARIFA APO BURSË STUDENTËT QË :**

- a. Studentët që vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi;
- b. Studentët përsëritës;

### **DOKUMENTACIONI DORËZOHET:**

- Nëpërmjet rrugës postare në adresën: “Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI), Sheshi Nënë Tereza Nr.1, Tiranë
- Prane zyres se Finances, çdo dite ora 10:00-12:00

Studentët aplikues duhet të dorëzojnë dokumentacionin deri ne daten 1 Dhjetor 2021.

Duhet që pëvec dokumentacionit të kërkuar të bashkëngjitin edhe një kërkesë me shkrim në të cilën të specifikohet për çfarë aplikojnë, bursë dhe ose përjashtim nga tarifa.

Sqarojmë se në rastin kur studentët janë përfitues edhe të bursës edhe të përjashtimit nga tarifa e shkollimit mjaftojnë të dorëzojnë vetëm një palë dokumenta origjinale( nuk është e nevojshme të paraqiten dy palë dokumenta)

Duhet që pëvec dokumentacionit të kërkuar të bashkëngjitin edhe një kërkesë me shkrim në të cilën të specifikohet për çfarë aplikojnë bursë dhe ose përjashtim nga tari



## KËRKESË

### PËR PËRFITIMIN E BURSËS DHE OSE PËRJASHTIMIN NGA TARIFA E SHKOLLIMIT VITI AKADEMIK 2021- 2022

*Drejtuar: Fakultetit te Teknologjise se Informacionit*

Unë \_\_\_\_\_, student i ciklit të parë Bachelor me kohë të plotë në Degën \_\_\_\_\_, viti \_\_\_\_\_, paraqes këtë kërkesë për të përfituar nga përjashtimi i tarifës së shkollimit dhe përfitimin e bursës për vitin akademik 2021- 2022, pasi jam student që i takoj kategorisë sociale

---

\_\_\_\_\_  
Studenti( Emër atësi mbiemër) dhe nënshkrimi

Telefon: \_\_\_\_\_

Email: \_\_\_\_\_

Shenim:

*Kërkesa nuk është e vlefshme nëse nuk ka të bashkëngjitur të gjithë dokumentat që kërkohen në njoftim e publikuar nga ana e Fakultetit të Teknologjise se Informacionit, sipas kategorisë përkatëse sociale*



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

